



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 10.07.2017

Vendim
Nr. 72, datë 10.07.2017

PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR ORGANIZIMIN E KONFERENCËS
SHKENCORE STUDENTORE

Në mbështetje të nenit **3**, pika **3**, shkronja **c** dhe nenit **38**, pika **1**, shkronja **a**, të Ligjit 80/20 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.07.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e fondit prej 211. 900 lekë, që i korrespondon 5 % të fondit të miratur për çdo fakultet për buxhetin 2017, për organizimin e një konference shkencore multidisiplinare për studentët.
2. Bashkëlidhur këtij vendimi është edhe preventivi për organizimin e konferencës.
3. Vendimi protokollohet dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim të mëtejshëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zv/rektori për Komunikim dhe Zhvillim Institucional, Administratori i Universitetit, Drejtoria e Financës dhe Realizimit të Buxhetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

PËR ORGANIZIMIN E KONFERENCËS SHKENCORE STUDENTORE

Qëllimi

Qëllimi i kësaj konference do të jetë prezantimi i kërkimeve shkencore të punuara nga vetë studentët (psh. tema diplomash, tema masteri, kërkime të tjera të përgatitura me pedagogë etj.). Kjo do të çojë në rritjen e angazhimit të studentëve në kërkime shkencore, përmirësimin e kapacitetit shkencor si dhe në përmirësimin e pjesëmarrjes më aktive në jetën akademiko-shkencore. Organizimi dhe menaxhimi i kësaj konference do të bëhet nga vetë studentët (studentët që janë anëtarë të Senatit Akademik si dhe kryetarët e Këshillave Studentore).

Projektbuxheti i konferencës

Projekt buxheti është konceptuar për një konferencë me rreth 200 pjesëmarrës.

Preventivi është bërë në bazë të preventivave të konferencave të fundit zhvilluar në UV.

Çmimet mund të ndryshojnë sipas ofertave të dhëna në Sistemin e Prokurimeve Publike.

	PERSHKRIMI I MALLIT	SASIA	CMIMI PËR NJËSI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1	Baner i qëndrueshem , me skelet druri, madhësia 150 m x 200 m (vertikal); material PVC, printim me ngjyra sipas modelit të dorëzuar nga Autoriteti Kontraktor.	1	7 900	7 900
2	Certifikatë A4 me letër 300 gr, të printuara me ngjyra, fleta të jetë e fortë, letra të jetë mat. Materiali do të merret pranë Autoritetit Kontraktor – çdo certifikatë do të ketë të njëjtën grafikë, por të dhëna të ndryshme.	200	100	20 000
3	Programi i konferencës , format A4 me nr faqesh 6, me qepje, printuar me ngjyra në letër me gramaturë 120 gr. Materiali do të merret prane Autoritetit Kontraktor.	200	60	12 000



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

4	Poster format A3 , me letër 170 gr, i printuar me ngjyrë, fleta të jetë e fortë, letra të jetë mat. Materiali do të merret pranë Autoritetit Kontraktor.	30	100	3 000
5	Dosje karton i bardhë me llastik , me printim me ngjyra sipas modelit të dorëzuar nga Autoriteti Kontraktor;	200	120	24 000
6	Karta identifikuese (badge) , me letër 300 gr, me mbajtëse plastike, me rrip blu. Me 2 logo të printuara me ngjyra, emrin e konferencës, datën dhe vendin për të shkruar emrin dhe mbiemrin e pjesëmarrësit.	200	70	14 000
7	Botim libri abstrakteve - formati 6.75” x 9.5” me nr. faqesh 70; - kopertina e plastifikuar, gramaturë 300gr, printim me 4ngjyra kolor CMYK; dizajni në përputhje me përmbajtjen e botimit; logon e universitetit, titullin e konferencës; - lidhja me qepje; - fletët e brendshme printuar me bardh e zi (vetëm 1 faqe me ngjyra) në letër me gramaturë 120 gr; faqosje të përshtatshme për botime të tipit, header&footer me titullin, të dhëna mbi botimin, nr. faqesh etj.	200	400	80 000
9	Medaljone me logo e UV-së - si çmim për 3 (tre) punimet më të mira, - Logo të UV-së që vendoset në tavolinë si suvenir, e derdhur ose e incizuar në bronz, e shoqëruar me kutinë e drurit të veshur me kadife me ngjyrë vishnje të errët me logon e UV-së printuar sipër. Logot duhet të jenë me dimensione, përafërsisht 12 me 12 cm, me mbajtëse të tejdukshme nga prapa.	3	7 000	21 000



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

8	<u>Kokteili</u>	200 persona	150	30 000
			TOTAL	211 900 lekë